

- Jini të kujdesshëm dhe mos publikoni shumë informacion dhe të dhëna personale në internet;
- Mos u besoni instant miqve në mediat sociale;
- Mos dërgoni foto, video të papërshtatshme me përmbajtje pornografike;
- Jini të kujdesshëm dhe mos u ekspozoni si pre e lehtë - trafikantët i targetojnë ata që janë vulnerabel dhe të nënshtruar;
- Mos u besoni atyre që ju ofrojnë famë dhe pasuri në mënyrë të shpejtë;
- Mos pranoni dhurata të shtrenjta nga persona të huaj;
- Rritni vetëbesimin, mësoni ta mbronni veten, mësoni arte marcialle;
- Edukohuni sa më shumë të jetë e mundur.

## ÇFARË NËSE FËMIJA JUAJ JU MBAN FSHEHTËSI DHE ËSHTË I MBYLLUR NË VETE?

Një nga gjërat më të rëndësishme që mund ta bëni është të inkurajoni komunikim të hapur me fëmijët tuaj.



Çelësi është komunikimi i hapur për marrëdhëniet e tyre dashurore-emocionale dhe miqësitë e reja. Nëse fëmija juaj e mban në fshehtësi marrëdhënien e re dhe është i tërhequr, atëherë kjo duhet parë si një sinjal paralajmërimi.

Është shumë e rëndësishme edhe që fëmija juaj të ndjejë se dikush kujdeset dhe e do atë. Sidomos në moshën delikate nga 10-14 vjeç kur janë më të ekspozuar e kur mund të bëhen cak i mashtuesve. Vajzat dhe djemtë në këtë moshë shpesh kalojnë nëpër shumë ndryshime dhe përballen me ngacmime ose probleme me vetëvlerësimin.

Të pasurit e një ndjenje të përkatësisë dhe mbrojtjes është e një rëndësie tejet të madhe, kjo i pengon grabitqarët ta ndiejnë zbrazëtinë dhe ta plotësojnë atë.


**KURRË NUK ËSHTË VONË PËR TË FOLURI!  
GJITHMONË ZGJIDHNI TË JENI TË SIGURT,  
SESA TË MOS THONI ASGJË!  
EKZISTON MBËSHTETJE PËR VIKTIMAT E  
MUNDSHME DHE VIKTIMAT E TRAFIKIMIT TË  
QENIEVE NJERËZORE**



**RAPORTIMI MUND TË  
JETË ANONIM!**

Kontakte për raportim dhe udhëzim:

- SOS linja falas **0800 1111**
- Qendra për viktimat **070 359 971**
- Porta e hapur **2777 070**
- Policia – njësia për luftë kundër trafikimit të qenieve njerëzore **192**



**SHMANGNI MUNDËSINË E TË  
QENIT VIKTIMË E TRAFIKIMIT  
TË QENIEVE NJERËZORE  
– DALLONI SHENJAT**

**INSTITUTI I SHËNDETIT PUBLIK I  
REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT**



## ÇFARË ËSHTË TRAFIKIMI ME QENIE NJERËZORE?

Trafikimi i qenieve njerëzore paraqet rekrutim, transportim, transferim, strehim, blerje dhe shitje të fëmijëve, burrave dhe grave nëpërmjet përdorimit të forcës, detyrimit, abuzimit të vulnerabilitetit, mashtrimit ose mjeteve të tjera të palejueshme për qëllime shfrytëzimi.

## KUSH MUND TË JETË VIKTIMË E TRAFIKIMIT ME QENIE NJERËZORE?

Secili nga ne mund të jetë viktimë! Pa dallim të moshës, gjinisë, racës, fesë apo kombësisë. Viktima mund të jetë pjesëtar i çfarë do pjese të spektrit socio-ekonomik. Megjithatë, për dallim nga të tjerët, viktimat me karakteristika dhe origjinë të caktuar janë pre më e lehtë se sa të tjerët për trafikantët e qenieve njerëzore.



Trafikantët prirën t'i zgjedhin viktimat e tyre nga anëtarë ekonomikisht dhe socialisht vulnerabël të shoqërisë. Ka më shumë gjasa që ata persona të jenë persona të mitur, të paqëndrueshëm, të dëshpëruar, që mashtrohen lehtë, ose që supozohet se janë të abuzuar dhe për të cilët rrallë kush kujdeset (i mbron ata).

Të rinjtë e varur nga substancat psikoaktive ose të rinjtë që përjetojnë dhunë fizike ose seksuale janë «kandidatë kryesorë» për trafikim të qenieve njerëzore për shfrytëzim seksual.

## SI REKRUTOHEN - JOSHEN VIKTIMAT E TRAFIKIMIT TË QENIEVE NJERËZORE?

Trafikantët zakonisht nuk përdorin forcë, ata e bëjnë atë në një mënyrë delikate duke përdorur: teknika psikologjike, informim në rrjetet sociale për fitime të mira me premtime të rreme, premtime për paga të larta, cilësi më të mirë të jetës, migrim në vendet perëndimore, e madje edhe oferta romantike.



## FORMAT E TRAFIKIMIT TË QENIEVE NJERËZORE

### Puna me detyrim - shfrytëzimi për punë

Migrantët-punëtorë janë veçanërisht tërheqës për trafikantët. «Ujditë» që ata bëjnë me trafikantët zakonisht përfshijnë kushte të rrezikshme pune dhe i hedhin ata në një skllavëri me një borxh, të cilin ata duhet të shlyejnë ndaj punëdhënësit për shpenzimet e udhëtimit, dhomës dhe ushqimit, e që shtohet më shpejt sesa që mund të fitojë punëtori për ta shlyer atë.

### Trafikimi seksual dhe martesat me detyrim

Dihet se shumica e përdhunimeve kryhen nga një person i njohur. Zakonisht, në të njëjtën mënyrë ndodh edhe trafikimi seksual. Viktimat shfrytëzohen seksualisht për përfitime nga të dashurit e tyre ose nga persona të cilët i njohin.

Ndonjëherë trafikantët inkuadrojnë të rinjtë të tjerë me interesa të njëjta si viktimat për të ndihmuar me mashtrimin dhe për të ndikuar tek viktimat.

Për fat të keq bashkëpunëtorë me trafikantët mund të jenë edhe anëtarët e familjes.

Për shembull, prindërit e varfër i shesin fëmijët e tyre ose i detyrojnë ata të martohen për përfitime financiare që u ndihmojnë pastaj për ta ushqyer pjesën tjetër të familjes.

### Kryerja e veprave penale me detyrim, lypja me detyrim

Prindërit, vëllezërit e motrat, kujdestarët ose një palë e tretë, si bandat kriminale, të afërmit e largët, fqinjët ose miqtë e familjes mund t'i detyrojnë fëmijët që të lypin.

Tashmë dimë raste kur fëmijët detyrohen të shesin xhingla, të argëtojnë kalimtarët ose të shtiren si të lënduar me qëllim që të ngjallin empati tek kalimtarët. Viktimave të lypjes së detyruar u jepen edhe rekuizita, si paterica, që ata të mund të tërheqin më shumë vëmendje. Këta viktimat shpesh përballen me mundësinë që dikush t'i rrahë, t'i kërcënojë me rrahje dhe vazhdimisht ndjejnë presion psikologjik.

### Heqja e organeve

Viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore që rrëmbehen me qëllim heqjen e organeve shpesh rekrutohen në mesin e grupeve vulnerabël, në të shumtën e rasteve nga ato që jetojnë në varfëri ekstreme. Trafikantët e qenieve njerëzore shpesh janë pjesë e grupeve të kimit të organizuar transnacional. Grupet e kimit të organizuar i joshin njerëzit jashtë vendit me premtime të rreme, pastaj i bindin ose i detyrojnë t'i shesin organet e tyre. Marrësit e organeve paguajnë një çmim shumë më të lartë nga ai që do të marrë dhuruesi.

Trafikantët e organeve përfitojnë në hije, ndërsa gjurmët shkatërruese mjekësore janë e vetmja gjë që ndjen viktimat.

## SI TA SHMANGNI MUNDËSINË PËR T'U BËRË VIKTIMË E TRAFIKIMIT TË QENIEVE NJERËZORE?

Një realitet fatkeq i trafikimit të qenieve njerëzore është se nuk mjafton vetëm të mësoni se si të shmangni «rreziqet nga të tjerët», por duhet të keni parasysht edhe rrezikun që anëtarë të familjes, partnerët intimë, fqinjët apo të njohurit mund të jenë roje të botës së errët të eksploatimit për punë të detyruar ose atij seksual (viktimë e kësaj janë fëmijët nën 18 vjeç).

Këshilla kryesore: Pa marrë parasysht se sa «të shtypur» jeni nga jeta dhe lufta për një të ardhme më të mirë, kini kujdes nga miqtë «e çastit» dhe ofertat për punës që duken «tepër të mira për të qenë të vërteta».

Masat parandaluese që gratë dhe burrat mund t'i marrin për ta shmangur mundësinë për t'u bërë viktimat të trafikimit të qenieve njerëzore